



## Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

## Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## Procesverbali i debatit publik për buxhetin 2022/2023- Fshati Bradash

Dëgjimin publik i cili u mbajt në fshatin Bradash për buxhetin e vitit 2022/2023, u hap diskutimi nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, duke krahasuar buxhetin e vitit 2023 me atë të vitit 2022. Por rritje progresive, Drejtori Osmani theksoi se do të ketë edhe rritje për vitet 2024 dhe 2025.

Nw debat publik për buxhetin e vitit 2023, pwrveç drejtorit tw Financave mori pjesw edhe Drejtori i Arsimit, Avni Fetahu.

Drejtori Osmani, theksoi se buxhetin për vitin 2023 është rritur për 4 milionë euro, më shumë se vitin 2022.

Gjithashtu, Drejtori theksoi edhe sektoret që i ka prioritet Komuna e Podujevës, si sektori i arsimit, sektori i shëndetësisë, bujqësisë dhe sektori i kulturës. Po ashtu, tregon për investimet kapitale që i ka bërë Komuna në sektorin e Arsimit, ku krahasuar me vitet e kaluara është një buxhet 15 herë më i madh se vitet e kaluara.

Ndërsa, theksoi edhe për sektorin e shëndetësisë që ka një rritje të vazhdueshme, si ndërtimi i urgjencës, furnizimi me paisje mjekësore, si dhe furnizim me barna.

Kurse, sa i përket fshatrave të Komunës së Podujevës, tregoi se thuajse secili fshat është në planin buxhetit për 2 vite.

Drejtori Osmani, u shpreh i hapur për kërkesat dhe sygjerimet që i kanë qytetarët për buxhetin e vitit 2023.

Banor i fshatit Bradash- Kërkoi nga dy drejtorët që ishin në debat publik të dijë më shumë rreth planeve që i ka Komuna e Podujevës, për fshatin Bradash. Po ashtu, tregoi për problemet që i kanë banorët e fshatit me vërshime, problemet më kanalizim dhe probleme me trotuare në disa lagje të fshatit dhe kërkoi për disa invesimet në shkollën e fshatit Bradash.

Bahri Kastrati, banor i fshatit Pakashticë të Epërme- U shpreh i pakënaqur me mospërfilljen e kahmotshme për asfaltimin e rrugës, trotuarit dhe ndriqimin e rrugës në atë lagje dhe ku ai jeton. Po ashtu, kërkoi nga Komuna të ndryshohet emërtimi i rrugës në lagjën ku ai jeton, me arsyen se emërtimi i tanishëm i rrugës nuk është para ardhës i familjes Kastrati. Gjithashtu, kërkoi të bëhen disa investime në shkollë, të rregullohet një fushë sporti në Kërpimeh, si dhe të rregullohet çështja e transportit publik nga Komuna.

Përfaqësues i lagjës Spahiu, fshati Bradash- Kërkon nga Komuna të bëhen disa investime për në hyrjen e Odës së lagjes. Gjithashtu, të largohen mbeturinat afër shkollës së fshatit Bradash, sepse fëmijët janë gjithmonë të rrezikuar nga qentë endacak. Ndërsa, sa i përket shkollës u shpreh i kënaqur më investimet që i ka bërë Komuna.

Banor i fshatit Bradash- Kërkon nga Komuna të rregullohet një pjesë e rrugës afër varrezave të fshatit Bradash, të rregullohet çështja e kanalizimit afër Odës së fshatit dhe gjithashtu kërkon nga Komuna të rregullohet ndriqimi i lagjes së familjes Spahiu dhe ndryshimi i emërtimit të rrugës në atë lagje.

Banor i fshatit Bradash- U shpreh i pakënaqur me vonesat që po bëhen nga kompania e pastrami, ku pastaj po hasin në probleme më qentë endacak. Gjithashtu, si kërkesë e banorit ishte të mbyllet gërmadha afër shkollës së fshatit Bradash.

Drejtori i Arsimit, Avni Fetahu- Thekson se është në proceduarë të furnizohen kabinetet e shkollave, duke përfshirë edhe shkollën e fshatit Bradash.

Ndërsa, për çështjen e investimeve në shkollën e fshatit Kërpimeh, Drejtori Fetahu tregoi se kanë filluar investimet në disa shkolla në qytet të Podujevës, kurse gjatë vitit tjetër tregon se është në plan të investohet në shkollat e fshatrave të Podujevës.

Gjithashtu, drejtori u shpreh i hapur për kërkesat dhe sygjerimet e banorëve që t'i shtrojnë edhe me shkrim në Komunë.

Drejtori i Financave, Fatlum Osmani- u përgjigjet banorëve, duke ju thënë, që të gjitha këto problematika do të marrin trajtimin e duhur dhe do të zgjedhen, ndërsa për projektet e infrastrukturës kemi buxhet të mjaftueshëm për rregullimin e çështjes së kanalizimeve apo ujërave të zeza, për dallim nga vitet e kaluara që ka qenë një buxhet shumë më i vogël se këtë vit dhe vitin e ardhshëm.

Gjithashtu, Drejtori Osmani theksoi, se Komuna është në bashkëpunim me Qeverinë në mënyrë që të rregullohet çështja e ujërave të zeza. Kurse, për ndërtimin e trotuareve tregoi se Komuna ka prioritet këtë problematikë, ku Drejtori Osmani u shprehë se gjatë vitit 2023 do të përfundojnë këto çështje.

Ndërsa, për investimet e fshatrave rithekssoi se në planin buxhetor të vitit 2023, parashihen në plan për dy vite.

Gjithashtu, për çështjet tjera Drejtori Osmani u shpreh se nëse nuk do të përfundojnë gjatë këtij viti, do të përfundojnë gjatë vitit 2023.

15 gusht, fshati Bradash





## Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Data: 15.08.2022

Ora: 17:00

Debati publik lista e nënshkrimeve për Buxhetin e vitit 2023 Lista e pjesëmarrësve

Emri	Mbiemri	Vendi		Nënshkrimi
FADIL	ZJMERI Moloky	BRADASH		And a
BAHRI	KASTRATI	PAKASHTIKË E EPËRME		BKmwahob)
ARTON	4071	BRADASH		Sleek-
Barran	Azemi	BRADASH		BAzerij
Ferking	Aul T	Brondord		Ryer
Illert	Alb Raulla	Broball		The y
JITIM	MALORU	BRADASH		FEA
AGIM	Italk!	BILADASH		MA
Commence of the second	(), 13 4 8 1 <sub>3 1</sub> × 18 10 4 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1	vi, tenga to p	# # CE 5 \$1 2 \$20 EE, \$ \$ 1	1 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2 2



Anarkt viele Zesensmitteln einkaufen Jus und miting land mene lydn